

# Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 1

## Paraqitja e Pasqyrave Financiare

### Objektivi

---

- 1 Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë bazat për paraqitjen e pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme, të sigurojë krahasueshmërinë e këtyre pasqyrave si me pasqyrat financiare të periudhave të mëparshme ashtu dhe me pasqyrat financiare të përgatitura nga njësi ekonomike të tjera. Për të arritur këtë objektivi, ky Standard paraqet të gjitha kërkesat për paraqitjen e pasqyrave financiare, udhëzime për strukturën e tyre dhe kërkesat minimale lidhur me përmbajtjen e tyre. Për të arritur këtë objektivi, ky Standard paraqet të gjitha kërkesat për paraqitjen e pasqyrave financiare, udhëzime për strukturën e tyre dhe kërkesat minimale lidhur me përmbajtjen e tyre.

### Objekti

---

- 2 **Ky Standard duhet të zbatohet për të gjitha pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme që përgatiten dhe paraqiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR-të).**
- 3 Pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme janë ato pasqyra që synojnë të plotësojnë nevojat e përdoruesve që nuk janë në pozitën të kërkojnë raporte speciale që të plotësojnë nevojat e tyre të veçanta për informacion. Pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme përfshijnë ato të paraqitura veçmas ose brenda një dokumenti tjetër publik si p.sh. një raport vjetor ose një prospektus. Ky Standard nuk zbatohet për strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të shkurtuara të përgatitura në përputhje me SNK 34 *Raportimi Financiar i Ndërmjetëm*. Megjithatë paragrafët 13–41 zbatohen për pasqyra financiare të tilla. Ky Standard zbatohet njëllë për të gjitha njësitë ekonomike dhe pavarësisht nëse ato kanë nevojë ose jo të përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara ose pasqyra financiare individuale, sic përcaktohet në SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale*.
- 4 [Fshirë]
- 5 Ky Standard përdor një terminologji që është e përshtatshme për njësitë ekonomike fitimprurëse, përfshirë njësitë e biznesit të sektorit publik. Njësitë ekonomike me aktivitet jo fitim prurës në sektorin privat, sektorin publik ose qeveritar që duan të zbatojnë këtë Standard mund të kenë nevojë të ndryshojnë përshkrimet lidhur me zëra të veçantë të pasqyrave financiare dhe për pasqyrat financiare në vetvete.
- 6 Në mënyrë të ngjashme, njësitë ekonomike që nuk kanë kapitalin neto të përcaktuar si në SNK 32 *Instrumentat financiarë: Paraqitja* (p.sh. disa fonde të përbashkëta) dhe njësitë, kapitali aksionar i të cilave nuk është kapitali neto (p.sh. njësitë ekonomike kooperative) mund të kenë nevojë të përshtasin paraqitjen në pasqyrat financiare të anëtarëve ose “mbajtësve të pjesëve” të interesit.

### Qëllimi i pasqyrave financiare

---

- 7 Pasqyrat financiare janë një paraqitje e strukturuar e pozicionit financiar dhe performancës financiare të një njësie ekonomike. Objektivi i pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme është të sigurojnë informacion lidhur me pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike që është i dobishëm për një grup të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve ekonomike. Pasqyrat financiare tregojnë gjithashtu dhe rezultatet e drejtimit lidhur me administrimin e burimeve që u janë besuar. Për të arritur këtë objektivi, pasqyrat financiare sigurojnë informacion lidhur me këto elementë të njësive ekonomike:

- (a) aktivet;
- (b) detyrimet;

- (c) kapitalin neto;
- (d) të ardhurat dhe shpenzimet, përfshirë fitimet dhe humbjet;
- (e) ndryshime të tjera në kapital; dhe
- (f) flukset monetare.

Ky informacion, së bashku me informacion tjetër në shënimet shpjeguese ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare në parashikimin e flukseve të ardhshme monetare të njësisë ekonomike dhe veçanërisht kohën dhe sigurinë e ndodhjes së tyre.

## **Përbërësit e pasqyrave financiare**

---

- 8 Një paketë e plotë e pasqyrave financiare përmban:**
- (a) një bilanc;
  - (b) një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve;
  - (c) një pasqyrë e ndryshimeve në kapital, ku tregohen,
    - (i) të gjitha ndryshimet në kapitalin neto, ose
    - (ii) ndryshimet në kapitalin neto, të cilat nuk kanë ardhur nga transaksionet me zotëruesit e kapitalit neto të kryera nga pozita e tyre si të tillë;
  - (d) një pasqyrë e fluksit të mjeteve monetare; dhe
  - (e) shënimet, që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shënime të tjera shpjeguese.
- 9 Shumë njësi ekonomike paraqesin, jashtë pasqyrave financiare, një rishikim financiar të bërë nga drejtimi i tyre, cili përshkruan dhe shpjegon veçoritë kryesore të performancës financiare dhe pozicionit financiar të njësisë ekonomike dhe pasiguritë kryesore që ndesh ajo. Një raport i tillë mund të përfshijë një rishikim të:
- (a) faktorëve dhe ndikimeve kryesorë që përcaktojnë performancën financiare, përfshirë ndryshimet në mjedisin në të cilin vepron njësi ekonomike, reagimin e njësisë ekonomike ndaj këtyre ndryshimeve dhe efektit të tyre dhe politikën e njësisë ekonomike për investimet për të mbajtur dhe rritur performancën financiare, përfshirë politikën e saj të dividendëve;
  - (b) burimet e financimit të njësisë ekonomike dhe raportin e synuar të detyrimeve ndaj kapitalit neto; dhe
  - (c) burimet e njësisë ekonomike që nuk janë njohur në bilancin e saj në përputhje me SNRF-të.
- 10 Shumë njësi ekonomike paraqesin gjithashtu, jashtë pasqyrave financiare, raporte dhe pasqyra të tilla si raporte mjedisore dhe pasqyra të vlerës së shtuar, veçanërisht në industri në të cilat faktorët mjedisorë janë të rëndësishëm dhe ku punonjësit shihen si një grup i rëndësishëm përdoruesish. Raportet dhe pasqyrat e paraqitura jashtë pasqyrave financiare janë jashtë objektit të SNRF-ve.

## **Përkufizime**

---

- 11 Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore që përdoren në këtë standard:**
- I pazbatueshëm* Zbatimi i një kërkesë është jo i mundur praktikisht atëhere kur njësi ekonomike nuk ka mundësi ta zbatojë atë dhe pas bërjes së të gjithë përpjekjeve të arsyeshme për ta zbatuar.
- Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)* janë Standarde dhe Interpretime të përdorura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BNSK). Ato përfshijnë:
- (a) Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
  - (b) Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit; dhe

- (c) Interpretatimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve për Raportimin Financiar Ndërkombëtar (KIRFN) ose dikur Komiteti në Pozitë për Interpretimet (KIS).

*Materialie* - Mungesa ose deklarime të gabuara të zërave janë materiale nëse ato në mënyrë individuale ose kolektive mund të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, vendime këto të marra në bazë të pasqyrave financiare. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e mungesave ose deklarimeve të gabuara (anomalive) të gjykuara nga rrethanat më të afërta. Madhësia ose natyra e zërit, ose një kombinim i të dyjave mund të jenë faktori përcaktues.

*Shënimet shpjeguese* përmbajnë informacion shtesë të atij të paraqitur në bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit monetar. Shënimet shpjeguese japin një përshkrim tregues ose detajim të zërave të paraqitur në këto pasqyra dhe informacion lidhur me zërat që nuk janë kualifikuar për njohje në këto pasqyra.

- 12 Vlerësimi nëse një mungesë ose deklarim i gabuar mund të ndikojë vendimet ekonomike të përdoruesve, pra të jetë material, kërkon marrjen në konsideratë të karakteristikave të atyre përdoruesve. *Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare* në paragrafin 25 deklaron se “përdoruesit supozohet që të kenë njohuri të arsyeshme për aktivitetet e biznesit e ekonomike dhe kontabilitetin dhe dëshirë për të studiuar informacionin me kujdes të arsyeshëm”. Pra vlerësimi duhet të marrë parasysh sesi përdoruesit me tipare të tilla mund të pritët, në mënyrë të arsyeshme, që të ndikohen në marrjen e vendimeve ekonomike.

## Konsiderata të përgjithshme

---

### Paraqitja e drejtë dhe pajtueshmëria me SNRF-të

- 13 Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon paraqitje besnike të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të dhëna në *Kuadër*. Zbatimi i SNRF-ve me dhënie informacionesh shpjeguese shtesë, kur është e nevojshme, supozohet të rezultojë në pasqyra financiare të cilat arrijnë një paraqitje të drejtë.
- 14 Një njësi ekonomike pasqyrat financiare të së cilës janë në pajtueshmëri me SNRF-të duhet të bëjë një deklarim të qartë dhe pa rezerva të kësaj pajtueshmërie në shënimet shpjeguese. Pasqyrat financiare nuk duhet të përshkruhen si të pajtueshme me SNRF-të në rast se ato nuk janë në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e SNRF-ve.
- 15 Pothuajse në të gjitha rrethanat, një paraqitje e drejtë arrihet nëpërmjet pajtueshmërisë me SNRF-të e zbatueshme. Një paraqitje e drejtë kërkon gjithashtu që një njësi ekonomike:
- (a) të zgjedhë dhe zbatojë politika kontabël në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*. SNK 8 paraqet një udhëzues të hierarkisë së autoritetit që drejtimi duhet të marrë parasysh në mungesë të një Standardi ose një Interpretimi që zbatohet në mënyrë specifike tek një zë.
  - (b) të paraqesë informacionin, përfshirë politikat kontabël, në një mënyrë që siguron informacion të rëndësishëm, të besueshëm, të krahasueshëm dhe të kuptueshëm.
  - (c) të sigurojë dhënie informacioni shpjegues shtesë atëhere kur pajtueshmëria me kërkesa të caktuara të SNRF është e pamjaftueshme që t’i mundësojë përdoruesit të kuptojnë ndikimin e transaksioneve të caktuara, ngjarjeve dhe kushteve të tjera, në pozicionin financiar dhe performancën financiare të njësisë ekonomike.
- 16 Politika të papërshtatëshme kontabël nuk korrigjohen as me dhënie informacionesh shpjeguese të politikave kontabël të përdorura dhe as nëpërmjet shënimeve shpjeguese ose materialit shpjegues.
- 17 Në rrethana shumë të rralla në të cilat drejtimi arrin në përfundimin se pajtueshmëria me një kërkesë të një Standardi ose një Interpretimi do të jetë kaq çorientuese sa do të sjellë një konflikt me objektivin e pasqyrave financiare të paraqitura në *Kuadër*, njësi ekonomike duhet të

- shmangë atë kërkesë sipas mënyrës së paraqitur në paragrafin 18 nëse një shmangie e tillë kërkohet nga kuadri përkatës rregullator ose nuk ndalohej prej tij.
- 18 Kur një njësi ekonomike shmanget nga një kërkesë e një Standardi ose e një Interpretimi në përputhje me paragrafin 17, duhet të japë informacion shpjegues:
- (a) që drejtimi ka arritur në përfundimin se pasqyrat financiare paraqesin me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike;
  - (b) që ato janë në pajtueshmëri me Standardet dhe Interpretimet e zbatueshme, me përjashtim të një kërkesë të caktuar nga e cila është shmangur për të arritur një paraqitja të drejtë;
  - (c) emrin e Standardit ose Interpretimit nga i cili është shmangur njësi ekonomike, natyrën e shmangies, përfshirë dhe trajtimin që do të kërkohet sipas Standardit ose Interpretimit, arsyen pse ky trajtim do të ishte kaq çorientues në rrethanat që do të sillte konflikt me objektivin e pasqyrave financiare të paraqitura në *Kuadër* dhe trajtimin e përdorur; dhe
  - (d) për secilën periudhë të paraqitur, ndikimin financiar të shmangies në secilin zë të pasqyrave financiare që do ishte raportuar në pajtueshmëri me kërkesën.
- 19 Kur një njësi ekonomike shmanget nga një kërkesë e një Standardi ose një Interpretimi në periudhën paraardhëse dhe kjo shmangie ndikon shumat e njohura në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, duhet të japë informacionin shpjegues të paraqitur në paragrafin 18 pikat (c) dhe (d).
- 20 Paragrafi 19 zbatohet, për shembull, kur një njësi ekonomike është shmangur në periudhën e mëparëshme nga një kërkesë e një Standardi ose e një Interpretimi për matjen e aktiveve ose detyrimeve dhe kjo shmangie ndikon matjen e ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet e njohura në pasqyrat financiare të periudhës aktuale.
- 21 Në rrethana shumë të rralla në të cilat drejtimi arrin në përfundimin se pajtueshmëria me një kërkesë të një Standardi ose një Interpretimi do të ishte kaq çorientuese sa do të sillte konflikt me objektivin e pasqyrave financiare të paraqitura në *Kuadër*, por që kuadri përkatës rregullator e ndalon shmangien nga kërkesa, njësi ekonomike duhet që me maksimumin e mundshëm të përpjekjeve të pakësojë apektet çorientuese të perceptuara lidhur me pajtueshmërinë duke dhënë informacion shpjegues mbi:
- (a) emrin e Standardit ose Interpretimit në fjalë, natyrën e kërkesës dhe arsyen pse drejtimi ka dalë në përfundimin se pajtimi me këtë kërkesë është kaq çorientues në rrethanat, sa do të sjellë konflikt me objektivin e pasqyrave financiare të paraqitura në *Kuadër*; dhe
  - (b) për secilën periudhë të paraqitur, rregullimet për çdo zë në pasqyrat financiare që drejtimi ka arritur në përfundimin se do të jenë të nevojshme për të arritur një paraqitje të drejtë.
- 22 Duke ju referuar paragrafëve 17–21, një zë informacioni do të jetë në konflikt me objektivin e pasqyrave financiare kur ai nuk paraqet në mënyrë besnike transaksionet, ngjarje dhe kushte të tjera që ai ose synon të paraqesë ose pritet në mënyrë të arsyeshme që të paraqesë dhe si pasojë ka gjasa të të ndikojë vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit e pasqyrave financiare. Kur vlerëson nëse pajtueshmëria me një kërkesë specifike të një Standardi ose një Interpretimi do të jetë kaq çorientuese sa do të sjellë konflikt me objektivin e pasqyrave financiare të paraqitura në *Kuadër*, drejtimi merr në konsideratë:
- (a) pse objektivi i pasqyrave financiare nuk arrihet në rrethanat specifike; dhe
  - (b) si ndryshojnë rrethanat e njësisë ekonomike nga rrethanat e njësisë të tjera ekonomike që janë në pajtueshmëri me kërkesën. Nëse njësi ekonomike të tjera në rrethana të ngjashme pajtohen me kërkesën, ekziston një mundësi kundërshtimi se pajtueshmëria e njësisë ekonomike me kërkesën nuk do të jetë kaq çorientuese sa të sjellë konflikt me objektivin e pasqyrave financiare të paraqitura në *Kuadër*.

## Vijimësia

- 23 Kur përgatit pasqyrat financiare, drejtimi duhet të bëjë një vlerësim të aftësisë së njësisë ekonomike për të vazhduar në vijimësi. Pasqyrat financiare duhet të përgatiten mbi bazën e vijimësisë me përjashtim të rasteve kur drejtimi synon të likujë njësinë ekonomike, ose të ndërpresë veprimtarinë e saj, ose kur nuk ka ndonjë alternativë tjetër realiste përveç se të veprojë në këtë mënyrë. Kur drejtimi është i ndërgjegjshëm, në bërjen e vlerësimit, për pasiguritë materiale të lidhura me ngjarjet ose kushtet të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar në vijimësi, për këto pasiguri duhet të jepen informacione shpjeguese. Kur pasqyrat financiare nuk përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë, ky fakt duhet të jepet në informacionet shpjeguese, së bashku me bazën sipas të cilës janë përgatitur pasqyrat financiare dhe arsye pse njësia ekonomike nuk shihet në vijimësi.
- 24 Për të vlerësuar nëse se supozimi i vijimësisë është ose jo i përshtatshëm, drejtimi i njësisë ekonomike duhet të mbajë parasysh të gjithë informacionin e vlefshëm për të ardhmen, që si periudhë është të paktën, por që nuk kufizohet vetëm në të, 12 muaj nga data e bilancit. Shkalla e marrjes parasysh varet nga faktet për secilin rast. Nëse një njësi ekonomike ka një histori operacionesh fitimprurëse, dhe disponim të menjëhershëm të burimeve financiare, përfundimi se baza e vijimësisë për kontabilitetin është e përshtatshme, mund të bëhet pa patur nevojë për analiza të detajuara. Në raste të tjera, drejtimi mund të ketë nevojë të vlerësojë një gamë të gjerë faktorësh që lidhen me përfitueshmërinë aktuale dhe atë të pritshme, grafiket e pagimit të borxheve dhe burimet e mundshme të zëvendësimit të financimit, përpara se të bindet se baza e vijimësisë është e përshtatshme.

## Kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara

- 25 Një njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat e saj financiare, me përjashtim të informacionit lidhur me fluksin monetar, duke përdorur kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
- 26 Kur përdoret kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, zërat njihen si aktive, detyrime, kapital neto, të ardhura dhe shpenzime (elementë të pasqyrave financiare) kur ato plotësojnë përkufizimet dhe kriteret për njohjen e këtyre elementëve të dhëna në *Kuadër*.

## Qëndrueshmëria e Paraqitjes

- 27 Paraqitja dhe klasifikimi i zërave në pasqyrat financiare duhet të mbahet e njëjtë nga njëra periudhë në tjetrën, përveç rasteve kur:
- (a) duket qartë se, pas një ndryshimi të rëndësishëm në natyrën e operacioneve të njësisë ekonomike, ose pas një rishikimi të pasqyrave të saj financiare, do të ishte më e përshtatshme një paraqitje ose klasifikim tjetër, duke mbajtur parasysh kriteret e përcaktuara në IAS 8 lidhur me zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël, ose
  - (b) një Standard ose një Interpretim kërkon një ndryshim në paraqitje.
- 28 Një blerje ose një nxjerrje jashtë përdorimit e rëndësishme ose një rishikim i paraqitjes së pasqyrave financiare, mund të sugjerojë se pasqyrat financiare duhet të paraqiten ndryshe. Një njësi ekonomik ndryshon paraqitjen e pasqyrave të saj financiare vetëm nëse paraqitja e re jep informacione që janë të besueshme dhe më të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave financiare dhe struktura e rishikuar pritet që të vazhdojë (dhe në të ardhmen), kështu që nuk do të dëmtohet krahasueshmëria. Ku bën ndryshime të tilla në paraqitje, një njësi ekonomike riklasifikon informacionin e vet krahasues në përputhje me paragrafët 38 dhe 39.

## Materialiteti dhe bashkimi

- 29 **Çdo klasë materiale e zërave të ngjashëm duhet të paraqitet veçmas në pasqyrat financiare. Zërat që nuk janë të së njëjtës natyrë ose funksion duhet të paraqiten veçmas me përjashtim të rastit nëse janë jo-materiale.**
- 30 Pasqyrat financiare rezultojnë nga përpunimi i një numri të madh transaksionesh ose ngjarjesh të tjera të cilat grupohen në klasa në përputhje me natyrën ose funksionin e tyre. Faza finale e procesit të bashkimit dhe klasifikimit është paraqitja e të dhënave të përmbledhura dhe të klasifikuara, të cilat formojnë zëra në bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit monetar, ose në shënimet shpjeguese. Nëse një zë nuk është individualisht material, ai bashkohet me zëra të tjerë në pasqyrat përkatëse ose në shënimet shpjeguese. Një zë që nuk është mjaftueshmërisht material për të siguruar një paraqitje të veçantë në këto pasqyra mund të jetë gjithësesi mjaftueshmërisht material për t'u paraqitur veçmas në shënimet shpjeguese.
- 31 Zbatimi i konceptit të materialitetit do të thotë se një kërkesë specifike për dhënie informacionesh shpjeguese në një Standard ose në një Interpretim mund të mos plotësohet nëse informacioni nuk është material.

## Kompensimi

- 32 **Aktivet dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet nuk duhet të kompensohen me përjashtim të rastit kur kjo gjë kërkohet ose lejohet nga një Standard ose një Interpretim.**
- 33 Është e rëndësishme që aktivet dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të raportohen veçmas. Kompensimi në pasqyrën e të ardhurave ose në bilanc, me përjashtim të rastit kur kompensimi reflekton thelbin e transaksionit ose një ngjarjeje tjetër, pakëson aftësinë e përdoruesve për të kuptuar transaksionet, ngjarjet dhe kushtet e tjera që kanë ndodhur dhe për të vlerësuar flukset e ardhshme monetare të njësisë ekonomike. Matja e aktiveve për vlerën neto nga zbritjet e vlerësuara—për shembull, amortizimi moral i inventarëve dhe zbritjet për borxhet e dyshimta në llogaritë e arkëtueshme—nuk është kompensim.
- 34 *SNK 18 Të ardhurat* përcakton të ardhurat dhe kërkon që ato të maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për t'u marrë, duke marrë parasysh shumën e çdo skontoje tregtare dhe zbritjeje tregtare mbi vëllimin, ofruar nga njësia ekonomike. Një njësi ekonomike ndërmerr, gjatë ciklit të veprimtarisë së saj të zakonshme, transaksione të tjera të cilat nuk gjenerojnë të ardhura por janë të rastësishme për aktivitetet kryesore që gjenerojnë të ardhura. Rezultatet e transaksioneve të tilla paraqiten, nëse kjo paraqitje reflekton thelbin e transaksionit ose një ngjarjeje tjetër, duke zbritur nga të ardhurat shpenzimet përkatëse që lidhen me të njëjtin transaksion. Për shembull:
- (a) fitimet neto dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata, përfshirë investimet dhe aktivet operative, raportohen duke zbritur nga të ardhurat e nxjerrjes jashtë përdorimit vlerën kontabël të aktivitetit dhe shpenzimet përkatëse të shitjes; dhe
  - (b) shpenzimet lidhur me një provizion të njohur në përputhje me *SNK 37 Provizionet, Pasivet dhe Aktivitetet e Kushiëzuara* dhe rimbursuar sipas një marrëveshjeje kontraktuale me një palë të tretë (për shembull një marrëveshjeje garancie me furnitorin) mund të kompensohen kundrejt rimbursimit përkatës.
- 35 Përveç kësaj fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup transaksionesh të ngjashme raportohen mbi bazë neto, për shembull, fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit ose fitimet dhe humbjet nga instrumentat financiarë të mbajtur për tregtim. Megjithatë fitime dhe humbje të tilla kur janë materiale raportohen veçmas.

## Informacion krahasues

- 36 **Me përjashtim të rastit kur lejohet ose kërkohet nga një Standard ose një Interpretim, për të gjitha shumat e raportuara në pasqyrat financiare duhet të jepet informacion krahasues me periudhën paraardhëse. Informacioni krahasues duhet të përfshihet për informacionin tregues**

- dhe përshkrues nëse është i rëndësishëm për kuptimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale.**
- 37 Në disa raste informacioni tregues i dhënë në pasqyrat financiare për periudhën (at) paraardhëse vazhdon të jetë i rëndësishëm në periudhën aktuale. Për shembull, detajet e një çështjeje gjyqësore, rezultati i së cilës ishte i pasigurt në datën e fundit të bilancit dhe është ende e pazgjidhur, duhet të jepen në periudhën aktuale. Përdoruesit përfitojnë nga informacioni mbi faktin se pasiguria ekzistonte në datën e bilancit të fundit dhe rreth hapave që janë marë gjatë periudhës për të zgjidhur pasigurinë.
- 38 **Nëse paraqitja ose klasifikimi i zërave në pasqyrat financiare ndryshohet, shumat krahasuese duhet të riklasifikohen me përjashtim të rasteve kur riklasifikimi është i pazbatueshëm. Nëse shumat krahasuese riklasifikohen një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për:**
- (a) natyrën e riklasifikimit;
  - (b) shumën e çdo zëri ose klase që riklasifikohet; dhe
  - (c) arsyen e riklasifikimit.
- 39 **Nëse riklasifikimi i shumave krahasuese është i pazbatueshëm, një njësi ekonomike duhet të jap informacion shpjegues lidhur me:**
- (a) arsyen e mos riklasifikimit të shumave; dhe
  - (b) natyrën rregullimeve që do të duhet të ishin bërë nëse shumat do të ishin riklasifikuar.
- 40 Rritja e krahasueshmërisë së informacionit ndërmjet periudhave ndihmon përdoruesit në marrjen e vendimeve ekonomike, veçanërisht duke mundësuar vlerësimin e prirjeve në informacionin financiar për qëllime parashikuese. Në disa rrethana është e pazbatueshme riklasifikimi i informacionit krahasues për një periudhë të caktuar paraardhëse për të arritur krahasueshmërinë me periudhën aktuale. Për shembull të dhënat në periudhën e mëparëshme mund të mos jenë grumbulluar në mënyrë që të lejojnë riklasifikimin dhe mund të mos jetë praktike rikrijimi i informacionit.
- 41 SNK 8 trajton rregullimet e informacionit krahasues që nevojitet kur një njësi ekonomike ndryshon një politikë kontabël ose korrigjon një gabim.

## **Struktura dhe përmbajtja**

---

### **Hyrje**

- 42 Ky Standard kërkon dhënien e informacionit shpjegues të vecantë për bilancin, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese për zëra të tjerë si në pasqyrat financiare ashtu dhe në shënimet shpjeguese. SNK 7 *Pasqyrat e Fluksit Monetar* jep kërkesat për paraqitjen e një pasqyre të fluksit monetar.
- 43 Ndonjëherë ky Standard përdor termin “dhënie informacionesh shpjeguese” në një kuptim më të gjerë, duke përfshirë zërat e paraqitur në bilanc, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit monetar si dhe zërat e paraqitura në shënimet shpjeguese. Dhënia e informacionit shpjegues kërkohet gjithashtu dhe nga Standarde dhe Interpretime të tjera. Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë Standard, ose në një Standard ose Interpretim tjetër, dhënie të tilla të informacioneve shpjeguese bëhen si në bilanc, në pasqyrën e të ardhurave, në pasqyrën e ndryshimeve në kapital ashtu dhe në pasqyrën e fluksit monetar (cilado qoftë e rëndësishme), ashtu dhe në shënimet shpjeguese.

### **Identifikimi i pasqyrave financiare**

- 44 **Pasqyrat financiare duhet të identifikohen qartë dhe të dallohen nga informacioni tjetër në njëjtin dokument të publikuar.**
- 45 SNRF-të zbatohen vetëm për pasqyrat financiare, dhe jo për informacionin tjetër të paraqitur në raportin vjetor apo tjetër dokument. Prandaj është e rëndësishme që përdoruesit të mund të dallojnë

informacionin e përgatitur duke përdorur SNRF-të nga informacioni tjetër që mund të jetë i dobishëm për përdoruesit por nuk është objekt i këtyre kërkesave.

- 46 **Çdo përbërës i pasqyrave financiare duhet të identifikohet qartë. Përveç kësaj, informacioni vijues duhet të paraqitet dukshëm dhe përsëritet kur është e nevojshme për një kuptim të saktë të informacionit të paraqitur:**
- (a) emri i njësisë ekonomike raportuese ose mjete të tjera identifikimi dhe ndonjë ndryshim në këtë informacion nga data e bilancit paraardhës;
  - (b) nëse pasqyrat financiare mbulojnë njësi ekonomike individuale ose një grup njësisish ekonomike;
  - (c) data e bilancit ose periudha e mbuluar nga pasqyrat financiare, cilado qoftë më e përshtatshme për atë përbërës të pasqyrave financiare;
  - (d) monedha e paraqitjes, sic përcaktohet në SNK 21 *Efektet e Ndryshimit në Kurset e Këmbimit*; dhe
  - (e) nivelin e rumbullakimeve të përdorura në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare.
- 47 Zakonisht kërkesat në paragrafin 46 plotësohen nëpërmjet paraqitjes së titujve të faqeve dhe titujve të shkurtuar në kolonat e çdo faqeje në pasqyrat financiare. Për të përcaktuar mënyrën më të mirë të paraqitjes së këtij informacioni është i nevojshëm të përdoret gjykimi. Për shembull, nëse pasqyrat financiare paraqiten në mënyrë elektronike jo gjithmonë përdoren faqe të ndara; zërat e mësipërm paraqiten mjaftueshëmrisht shpesh për të siguruar një kuptim të përshtshëm të informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare.
- 48 Shpesh pasqyrat financiare bëhen më të kuptueshme nëpërmjet paraqitjes së informacionit në mijëra ose milionë njësi të monedhës së paraqitjes. Kjo është e pranueshme për sa kohë që niveli i rumbullakimit në paraqitje jepet në informacionin shpjegues dhe informacioni material nuk humbet

## Periudha e raportimit

- 49 **Pasqyrat financiare duhet të paraqiten të paktën një herë në vit. Nëse data e bilancit të një njësie ekonomike ndryshon dhe pasqyrat financiare vjetore paraqiten për një periudhë më të gjatë ose më të shkurtër se një vit, përveç periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për:**
- (a) arsyen e përdorimit të një periudhe më të gjatë ose më të shkurtër; dhe
  - (b) faktin që shumat krahasuese në pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit monetar dhe shënimet shpjeguese përkatëse, nuk janë plotësisht të krahasueshme.
- 50 Zakonisht pasqyrat financiare të përgatitura mbulojnë një periudhë një vjeçare. Megjithatë për qëllime praktike disa njësi ekonomike preferojnë të raportojnë, për shembull për një periudhë 52 javore. Ky Standard nuk pengon këtë praktikë pasi pasqyrat financiare që rezultojnë kanë pak mundësi që të kenë ndryshime materiale nga ato që do të paraqiteshin për një periudhë një vjeçare.

## Bilanci kontabël

### Dallimi afatshkurtër/ afatgjatë

- 51 **Një njësi ekonomike duhet të paraqesë aktivet afatshkurtra dhe afatgjata, dhe detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata si klasifikime të veçanta në bilancin kontabël në përputhje me paragrafët 57–67 me përjashtim kur një paraqitje bazuar në nivelin e likuiditetit siguron informacion që është i besueshëm dhe më i rëndësishëm. Nëse ky përjashtim zbatohet, të gjitha aktivet dhe detyrimet duhet të paraqiten gjerësisht sipas nivelit të likuiditetit.**
- 52 **Cilado metodë paraqitje që përdoret, për cdo zë aktivesh dhe detyrimesh që bashkon shumat e pritshme për t'u marrë ose paguar (a) jo më shumë se dymbëdhjetë muaj pas datës së bilancit dhe (b) përtej dymbëdhjetë muajve pas datës së bilancit, njësia ekonomike duhet të jap**



**informacion shpjegues për shumën e pritur për t'u marrë ose paguar pas më shumë se dymbëdhjetë muajve.**

- 53 Nëse një njësi ekonomike furnizon mallra ose shërbime brenda një cikli shfrytëzimi qartësisht të identifikueshëm, klasifikimi veçmas i aktiveve e detyrimeve afatshkurtëra dhe afatgjata në bilancin kontabël siguron informacion të dobishëm duke dalluar aktivet neto që qarkullojnë në mënyrë të vazhdueshme si kapital punues nga ato të përdorura në operacionet afatgjatë të njësisë ekonomike. Një klasifikim i tillë thekson gjithashtu aktivet që priten të realizohen brenda ciklit aktual të shfrytëzimit dhe detyrimet që duhen shlyer brenda së njëjtës periudhë.
- 54 Për disa njësi, të tilla si institucionet financiare, paraqitja e aktiveve dhe detyrimeve në rendin rritës ose zbritës të likuiditetit siguron informacion që është i besueshëm dhe më i rëndësishëm se në një paraqitje afatshkurtër / afatgjatë pasi njësi ekonomike nuk ofron mallra ose shërbime brenda një cikli shfrytëzimi të identifikueshëm qartë.
- 55 Gjatë zbatimit të paragrafit 51, një njësi ekonomike lejohet të paraqesë disa aktive dhe detyrime të saj duke përdorur klasifikimin afatshkurtër / afatgjatë dhe të tjerët (zërat) sipas rendit të likuiditetit kur kjo siguron informacion që është i besueshëm dhe më i rëndësishëm. Nevoja për paraqitje me bazë të përzier mund të lindë nëse një njësi ekonomike kryen operacione të ndryshme.
- 56 Informacioni lidhur me datat e pritshme të realizimit të aktiveveve dhe detyrimeve është i dobishëm në vlerësimin e likuiditetit dhe aftësisë paguese të një njësie ekonomike. SNRF 7 *Instrumentat Financiarë*: Dhënie informacionesh shpjeguese kërkon dhënie e informacioneve shpjeguese për datat e maturimit të aktiveve dhe detyrimeve financiare. Aktivet financiare përfshijnë llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme dhe detyrimet financiare përfshijnë detyrimet tregëtare dhe llogari të pagueshme të tjera. Informacioni lidhur me datën e pritshme të marrjes ose shlyerjes së aktiveve dhe detyrimeve jo-monetare si p.sh. inventarët dhe provizionet është gjithashtu i dobishëm pavarësisht nëse aktivet dhe detyrimet janë ose jo të klasifikuara si afatshkurtëra ose afatgjata. Për shembull një njësi ekonomike jep informacion shpjegues për vlerën e inventarëve që priten të merren përtej dymbëdhjetë muajve nga data e bilancit.

**Aktivët afatshkurtra**

- 57 Një aktiv duhet të klasifikohet si afatshkurtër nëse ai plotëson njërin nga kriteret vijuese:
- (a) pritet që të realizohet ose mbahet për shitje ose konsum brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike;
  - (b) mbahet kryesisht për qëllime tregtimi;
  - (c) pritet që të realizohet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së bilancit; ose
  - (d) Është në formën e mjeteve monetare ose një ekuivalenti të mjeteve monetare (sic përcaktohet në SNK 7) me përjashtim të rastit kur ai kufizohet për t'u përdorur për këmbim ose për shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së bilancit.

**Të gjitha aktivet e tjera duhet të klasifikohen si afatgjata.**

- 58 Ky standard përdor termin “afatgjatë” për të përfshirë aktivet e prekshme, të paprekshme dhe financiare me natyrë afatgjatë. Ai nuk ndalon përdorimin e përshkrimeve alternative për sa kohë që kuptimi i tyre është i qartë.
- 59 Cikël shfrytëzimi i një njësie ekonomike është koha mes blerjes së aktiveve për përpunim dhe realizimin (shndërrimin) e tyre në mjete monetare ose ekuivalentë të mjeteve monetare. Nëse cikli normal i shfrytëzimit të njësisë ekonomike nuk është i identifikueshëm qartë, supozohet se ai zgjat dymbëdhjetë muaj. Aktivët afatshkurtra përfshijnë aktive (si inventarët dhe llogari të arkëtueshme tregtare) që shiten, konsumohen ose realizohen si pjesë e ciklit normal të shfrytëzimit edhe kur nuk priten që ato të realizohen brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së bilancit. Aktivët afatshkurtra përfshijnë gjithashtu aktivet e mbajtura kryesisht për qëllime tregtimi (aktivet financiare brenda kësaj kategorie klasifikohen si të mbajtura për tregtim në përputhje me SNK 39 *Instrumentat Financiarë*: *Njohja dhe matja*) dhe pjesa afatshkurtër e aktiveve financiare afatgjata.

## Detyrime afatshkurtëra

- 60 Një detyrim duhet të klasifikohet si afatshkurtër nëse ai plotëson njërin nga kriteret vijuese:
- (a) pritet që të shlyhet brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike;
  - (b) mbahet kryesisht për qëllime tregtimi;
  - (c) ; ose
  - (d) njësia ekonomike nuk ka ndonjë të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyerjes së detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së bilancit.
- Të gjitha detyrimet e tjera duhet të klasifikohen si afatgjata.**
- 61 Disa detyrime afatshkurtëra, si p.sh. llogaritë e pagueshme tregëtare dhe disa detyrime të konstatuara për punonjësit dhe kosto të tjera të shfrytëzimit, janë pjesë e kapitalit punues të përdorur në ciklin normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike. Zëra të tillë shfrytëzimi klasifikohen si detyrime afatshkurtëra edhe pse mund të duhet të shlyhen përtej dymbëdhjetë muajve nga data e bilancit. Për klasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve të një njësie ekonomike zbatohet i njëjti cikël normal shfrytëzimi. Nëse cikli normal i shfrytëzimit të njësisë ekonomike nuk është i identifikueshëm qartë, supozohet se ai zgjat dymbëdhjetë muaj.
- 62 Detyrime afatshkurtëra të tjera nuk shlyhen si pjesë e ciklit normal të shfrytëzimit, por duhet të shlyhen brenda dymbëdhjetë muajve nga data e bilancit ose mbahen kryesisht për qëllime tregtimi. Shembuj janë detyrimet financiare të klasifikuara si të mbajtura për tregtim në përputhje me SNK 39, overdraftet bankare dhe pjesa afatshkurtër e detyrimeve financiare afatgjata, dividendët e pagueshëm, tatimet mbi të ardhurat dhe llogaritë e pagueshme jo tregtare. Detyrimet financiare që sigurojnë financim për periudha afatgjata (d.m.th që nuk janë pjesë e kapitalit punues të përdorur gjatë ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike) dhe nuk kërkohen për t'u shlyer brenda dymbëdhjetë muajve nga data e bilancit janë detyrime afatgjata, objekt i paragrafëve 65 dhe 66.
- 63 Një njësi ekonomike klasifikon detyrimet e saj financiare si afatshkurtëra kur ato kërkohen për t'u shlyer brenda dymbëdhjetë muajve nga data e bilancit edhe nëse:
- (a) afati fillestar ishte për një periudhë më të gjatë se dymbëdhjetë muaj; dhe
  - (b) një marrëveshje për rfinansimin ose riskedulimin e pagesave në baza afatgjata përfundon pas datës së bilancit dhe para se të autorizohet nxjerrja e pasqyrave financiare.
- 64 Nëse një njësi ekonomike pret dhe ka mundësinë që të rifinancojë ose të shtyjë një detyrim për të paktën dymbëdhjetë muaj nga data e bilancit për një hua ekzistuese, ajo e klasifikon detyrimin si afatgjatë edhe pse ndryshe do të duhej ta shlyejë brenda një periudhe më të shkurtër. Megjithatë, nëse rfinansimi ose shtyrja e detyrimit nuk varet nga njësia ekonomike (për shembull nuk ekziston një marrëveshje rfinansimi), mundësia e rfinansimit nuk merret në konsideratë dhe detyrimi klasifikohet si afatshkurtër.
- 65 Nëse një njësi ekonomike shkel një premtim lidhur me një marrëveshje huaje afatgjatë në datën e bilancit ose më parë, me efekte që detyrimi bëhet i pagueshëm në të parë, detyrimi klasifikohet si afatshkurtër edhe nëse huadhënësi ka rënë dakord pas datës së bilancit dhe para autorizimit për nxjerrjen e pasqyrave financiare, të mos kërkohet shlyerjen e huasë si pasojë e shkeljes. Detyrimi klasifikohet si afatshkurtër sepse në datën e bilancit, njësia ekonomike nuk ka ndonjë të drejtë të pakushtëzuar të shtyjë shlyerjen e tij për të paktën dymbëdhjetë muaj pas asaj date.
- 66 Megjithatë detyrimi klasifikohet si afatgjatë nëse huadhënësi ka rënë dakord që në datën e bilancit të ofrojë një periudhë faljeje që përfundon të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së bilancit brenda të cilës njësia ekonomike mund të korrigjojë shkeljen dhe gjatë së cilës huadhënësi nuk mund të kërkojë ripagimin e menjëhershëm.
- 67 Lidhur me huatë e klasifikuara si detyrime afatshkurtëra, nëse ngjarjet vijuese ndodhin ndërmjet datës së bilancit dhe datës së miratimit të nxjerrjes së pasqyrave financiare, këto ngjarje plotësojnë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese si ngjarje jo-rregulluese në përputhje me SNK 10 *Ngjarje Pas Datës së Bilancit*:
- (a) rfinansim për periudha afatgjata;
  - (b) korrigjimi i shkeljes së një marrëveshje huaje afatgjatë; dhe

- (c) marrja nga huadhënësi e një periudhe faljeje për të korrigjuar një shkelje të një marrëveshjeje afatgjatë huaje që përfundon të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së bilancit.

### **Informacioni për t'u paraqitur në Bilancin Kontabël**

**68** Bilanci duhet të përfshijë minimalisht zërat që paraqesin shumat vijuese deri në nivelin që ato nuk janë paraqitur në përputhje me paragrafin 68A:

- (a) toka, ndërtesa, makineri e pajisje;
- (b) aktiv afatgjatë material i investuar
- (c) aktivet jo-materiale;
- (d) aktive financiare (përjashtuar shumat e paraqitura në pikat (e), (h) dhe (i));
- (e) investimet që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto;
- (f) aktivet biologjike;
- (g) inventarët;
- (h) llogari të arkëtueshme tregëtare dhe llogari të tjera të arkëtueshme;
- (i) mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare;
- (j) llogari të pagueshme tregëtare dhe llogari të tjera të pagueshme;
- (k) provizionet;
- (l) detyrimet financiare (përjashtuar shumat e paraqitura në pikat (j) dhe (k));
- (m) detyrimet dhe aktivet për tatimin aktual, sic përcaktohet në SNK 12 *Tatimet mbi të Ardhurat*;
- (n) detyrimet dhe aktivet për tatimin aktual, sic përcaktohet në SNK 12;
- (o) interesi i pakicës, paraqitur brenda kapitalit neto; dhe
- (p) kapitali dhe rezervat që i atribuohen zotëruesve të kapitalit neto të shoqërisë mëmë.

**68A** Bilanci duhet të përfshijë gjithashtu dhe zërat që paraqesin shumat vijuese:

- (a) totalin e aktiveve të klasifikuara si të mbajtura për shitje dhe aktiveve të përfshira në grupe për nxjerrje jashtë përdorimit të klasifikuara si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 5 *Aktive Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Veprimtaritë e Ndërprera*; dhe
- (b) detyrimet e përfshira në grupet për nxjerrje jashtë përdorimit të klasifikuara si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 5.

**69** Në bilanc duhet të paraqiten dhe zëra shtesë, tituj dhe nëntotale nëse një paraqitje e tillë është e rëndësishme për të kuptuar pozicionin financiar të njësisë ekonomike.

**70** Nëse një njësi ekonomike paraqet aktivet afatshkurtra e afatgjata dhe detyrimet afatshkurtra e afatgjata si klasifikime të veçanta në bilancin e vet kontabël, aktivet (detyrimet) për tatime të shtyra nuk duhet të klasifikohen si aktive (detyrime) afatshkurtra.

**71** Ky Standard nuk përshkruan renditjen ose formatin sipas të cilit duhet të paraqiten zërat. Paragrafi 68 thjesht siguron një listë të zërave që janë mjaftueshmërisht të ndryshëm në natyrë ose funksion për të siguruar një paraqitje të veçantë në bilancin kontabël. Veç kësaj:

- (a) zërat përfshihen, paraqiten me vete, nëse madhësia, natyra ose funksioni i një zëri ose grupi zërash të ngjashëm është i tillë që paraqitja e veçantë është e rëndësishme për të kuptuar pozicionin financiar të njësisë ekonomike. dhe
- (b) përshkrimet e përdorura dhe radhitja e zërave ose grupeve të zërave të ngjashëm mund të ndryshohet në përputhje me natyrën e njësisë ekonomike dhe transaksioneve të saj, për të siguruar informacion që është i rëndësishëm për të kuptuar pozicionin financiar të njësisë ekonomike. Për shembull, një institucion financiar mund të ndryshojë përshkrimet e

mësipërme për të siguruar informacion i cili është i rëndësishëm për operacionet e një institucioni financiar.

- 72 Gjykimi nëse zërat shtesë paraqiten veçmas ose jo, mbështetet në vlerësimin e:
- (a) natyrës dhe likuiditetit të aktiveve;
  - (b) funksionit të aktiveve brenda njësisë ekonomike; dhe
  - (c) shumave, natyrës dhe kohës së shlyerjes së detyrimeve.
- 73 Përdorimi i bazave të ndryshme të matjes për klasa të ndryshme të aktiveve sugjeron se ato janë të ndryshme në natyrë ose funksion, prandaj duhet të paraqiten si zëra të veçantë. Për shembull klasa të ndryshme të tokës, ndërtesave, makinerive e pajisjeve mund të mbahen me kosto ose me shuma të rivlerësuara në përputhje me SNK 16 *Toka, Ndërtesa, Makineri e Pajisje*.

### **Informacioni për t'u paraqitur si në bilancin kontabël ashtu dhe në shënimet shpjeguese**

- 74 **Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, si në bilancin kontabël ashtu dhe në shënimet shpjeguese, për nënklasifikime të mëtejshme të zërave të paraqitur, klasifikuar në një mënyrë të përshtatshme për operacionet e njësisë ekonomike.**
- 75 Niveli i detajeve në nënklasifikimet varet nga kërkesat e SNRF-ve dhe madhësia, natyra dhe funksioni i shumave të përfshira. Për të vendosur për bazën e nënklasifikimit përdoren gjithashtu edhe faktorët e ekspozuar në paragrafin 72, Dhënia e informacionit shpjegues ndryshon për cdo zë, për shembull:
- (a) zërat për tokën, ndërtesat, makineritë e pajisjet zbërthehen në klasa në përputhje me SNK 16;
  - (b) llogaritë e arkëtueshme zbërthehen në shuma për t'u arkëtuar nga klientët tregtarë, të arkëtueshme nga palët e lidhura, parapagime dhe shuma të tjera;
  - (c) inventarët ndahen në nënklasa në përputhje me SNK 2 *Inventarët*, në klasifikime të tilla si mallra, furnizime për prodhim, materiale, prodhim në proces dhe produkte të përfunduara;
  - (d) provizionet zbërthehen në provizione për përfitimet e punonjësve dhe zëra të tjerë; dhe
  - (e) kapitali neto i kontribuar dhe rezervat zbërthehen në disa klasa si kapitali i paguar, prime të kapitalit dhe rezervat.
- 76 **Një njësi ekonomike duhet të jap informacion shpjegues vijues në bilanc ose në shënimet shpjeguese:**
- (a) **për secilën klasë të kapitalit aksionar:**
    - (i) numrin e aksioneve të autorizuara;
    - (ii) numrin e aksioneve të emetuara dhe paguara plotësisht dhe atyre të emetuara por jo të paguara plotësisht;
    - (iii) vlerën nominale për aksion, ose faktin që aksionet nuk kanë vlerë nominale;
    - (iv) një rakordim të numrit të aksioneve të papaguara gjendje në fillim dhe në fund të periudhës;
    - (v) të drejtat, preferencat dhe kufizimet për secilën klasë duke përfshirë dhe kufizimet lidhur me shpërndarjen e dividendëve dhe ripagimin e kapitalit;
    - (vi) aksionet e njësisë ekonomike të mbajtura nga vetë njësia ekonomike ose nga filialet ose pjesëmarrjet e saj; dhe
    - (vii) aksionet e rezervuara për t'u përdorur për t'u emetuar kundrejt opcioneve dhe kontratave për shitjen e aksioneve, përfshirë afatet dhe shumat; dhe
  - (b) një përshkrim i natyrës dhe qëllimit të cdo rezerve brenda kapitalit neto.
- 77 **Një njësi ekonomike pa kapital aksionar, të tilla si një bashkëpronësi ose trust, duhet të japë informacion shpjegues ekuivalent me atë të kërkuar nga paragrafi 76(a), duke treguar**

ndryshimet gjatë periudhës në secilën kategori të interesit në kapital dhe të drejtat, preferencat dhe kufizimet për secilën kategori të interesit në kapital.

## Pasqyra e të ardhurave

### Fitimi ose humbja e periudhës

- 78 Të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë një periudhe duhet të përfshihen në fitim ose humbje me përjashtim të rastit kur një Standard ose një Interpretim kërkon ndryshe.
- 79 Zakonisht të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë një periudhe duhet të përfshihen në fitim ose humbje. Kjo përfshin dhe efektet e ndryshimeve në çmuarjet kontabël. Megjithatë ekzistojnë rrethana kur një zë i veçantë mund të përjashtohet nga fitimi ose humbja e periudhës aktuale. SNK 8 trajton dy rrethana të tilla: korigjimi i gabimeve dhe efekti i ndryshimeve në politikat kontabël.
- 80 Standarde të tjera trajtojnë zëra që mund të plotësojnë përkufizimet e *Kuadrit* për të ardhurat ose shpenzimet por që zakonisht përjashtohen nga fitimi ose humbja. Shembuj të tillë janë tepricat e rivlerësimit (shih SNK 16), fitime dhe humbje të caktuara që vijnë nga përkthimi i pasqyrave financiare të një njësie ekonomike që operon jashtë vendit (shih SNK 21) dhe fitime ose humbje në rivlerësimin e aktiveve financiare të vlefshme për shitje (shih SNK 39).

### Informacioni për t'u paraqitur në pasqyrën e të ardhurave

- 81 Pasqyra e të ardhurave duhet të përmbajë minimalisht zërat që paraqesin shumat vijuese për periudhën:
- (a) të ardhurat;
  - (b) kostot e financimit;
  - (c) pjesën e fitimit ose humbjes në pjesëmarjet dhe shoqëritë e përbashkëta të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto;
  - (d) shpenzimet për tatimet dhe taksat;
  - (e) një shumë të vetme që përfshin totalin e (i) fitimit ose humbjes pas tatimit të veprimtarive të ndërprera dhe (ii) fitimit ose humbjes pas tatimit të njohura gjatë matjes me vlerën e drejtë minus koston e shitjes ose koston e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve ose grup aktiveve që përbëjnë veprimtari të ndërprerë, dhe
  - (f) Fitimin ose humbjen.
- 82 Pasqyra e të ardhurave duhet të paraqesë zërat vijues, si fitim ose humbje e shpërndarë për periudhën:
- (a) fitimi ose humbja që i takon interesave të pakicës; dhe
  - (b) fitimi ose humbja që i takon zotëruesve të kapitalit neto të shoqërisë mëmë.
- 83 Në pasqyrën e të ardhurave duhet të paraqiten dhe zëra shtesë, tituj dhe nëntotale nëse një paraqitje e tillë është e rëndësishme për të kuptuar performancën financiare të njësisë ekonomike.
- 84 Duke qenë se efektet e aktiviteteve të ndryshme të një njësie ekonomike, e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera ndryshojnë në shpeshësi, mundësinë për fitim ose humbje dhe parashikueshmëri, dhënia e informacioneve shpjeguese lidhur me përbërësit e performancës financiare, ndihmon për të kuptuar performancën financiare të arritur dhe në bërjen e parashikimeve për rezultatet e ardhshme. Në pasqyrën e të ardhurave mund të shtohen zëra si dhe mund të ndryshohen përshkrimet e përdorura dhe radhitja e zërave nëse kjo është e nevojshme për të shpjeguar elementët e performancës financiare. Faktorët që duhet të merren parasysh për këtë rast përfshijnë materialitetin, natyrën dhe funksionin, e përbërësve të të ardhurave dhe shpenzimeve. Për shembull, një institucion financiar mund të ndryshojë përshkrimet

për të dhënë informacion i cili është i rëndësishëm për operacionet e një institucioni të tillë. Zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve nuk kompensohen me përjashtim të rastit kur plotësohen kriteret e paragrafit 32.

- 85 **Një njësi ekonomike nuk duhet të paraqesë si zëra të jashtëzakonshëm asnjë zë të të ardhurave ose shpenzimeve, as në pasqyrën e të ardhurave as në shënimet shpjeguese.**

### **Informacioni për t'u paraqitur në pasqyrën e të ardhurave ose në shënimet shpjeguese**

- 86 **Kur zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve janë materiale, natyra dhe shuma e tyre duhet të paraqitet veçmas.**

87 Rrethanat që sjellin një paraqitje të veçantë të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë:

- (a) zhvlerësime të inventarëve në vlerën neto të realizueshme ose zhvlerësime të tokës, ndërtesës, makinerive e pajisjeve tek shumat e rikuperueshme, ashtu si dhe anulim i këtyre zhvlerësimeve;
- (b) ristrukturimi i aktiviteteve të një njësie ekonomike dhe anulimi i çdo provizioni lidhur me kostot e ristrukturimit;
- (c) nxjerrjet jashtë përdorimit të zërave si toka, ndërtesa, makineri e pajisje;
- (d) nxjerrjet jashtë përdorimit të investimeve;
- (e) operacionet e ndërprera;
- (f) zgjidhjet e çështjeve gjyqësore; dhe
- (g) anulime të tjera provizionesh.

- 88 **Një njësi ekonomike duhet të paraqesë një analizë të shpenzimeve duke përdorur klasifikimin e bazuar në natyrën e shpenzimeve ose në funksionin e tyre brenda njësisë ekonomike, cilado siguron informacion që është i besueshëm dhe më i rëndësishëm.**

89 Njësitë ekonomike nxiten të paraqesin analizat e dhëna në paragrafin 88, në pasqyrën e të ardhurave.

90 Shpenzimet nënklasifikohen për të nënvizuar përbërësit e performancës financiare që mund të jenë të ndryshëm në terma të shpeshtësisë, mundësisë për fitim apo humbje dhe parashikueshmërisë. Kjo analizë jepet në një nga dy format.

91 Forma e parë e analizës është metoda e shpenzimeve sipas natyrës. Shpenzimet grupohen në pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës së tyre (për shembull, amortizimi, blerja e materialeve, kostot e transportit, përfitimet e punonjësve dhe kostot e reklamave), dhe nuk rishpërndahen sipas funksioneve të ndryshme brenda njësisë ekonomike. Kjo metodë mund të zbatohet thjesht pasi nuk janë të nevojshme shpërndarje të shpenzimeve sipas funksionit. Një shembull i klasifikimit duke përdorur metodën e shpenzimeve sipas natyrës jepet në vijim:

Të ardhurat		X
Të ardhura të tjera		X
Ndryshime në inventarin e produkteve të përfunduara dhe prodhimit në proces	X	
Lëndë të para dhe të konsumueshme të përdorura	X	
Shpenzimet lidhur me përfitimet e punonjësve	X	
Shpenzimet e amortizimit	X	

	Shpenzime të tjera	X	
		<hr/>	
	Totali i shpenzimeve		(X)
			<hr/>
	Fitimi		X
			<hr/>
92	<p>Forma e dytë e analizës është funksioni i shpenzimit ose metoda e “kostos së shitjeve” që klasifikon shpenzimet sipas funksionit të tyre si pjesë e kostove të shitjes, ose për shembull kostot e aktiviteteve të shpërndarjes ose administrative. Sipas kësaj metode një njësi ekonomike paraqet minimalisht kostot e saj të shitjeve veçmas nga shpenzimet e tjera. Kjo metodë mund të japë informacion më të rëndësishëm për përdoruesit se klasifikimi i shpenzimeve sipas natyrës por shpërndarja e kostove sipas funksioneve mund të kërkojë shpërndarje arbitrare dhe përfshin përdorimin e një gjykimi të madh. Një shembull i klasifikimit duke përdorur metodën e shpenzimeve sipas funksionit jepet në vijim:</p>		
	Të ardhurat		X
	Kosto të shitjeve		(X)
		<hr/>	
	Fitimi bruto		X
	Të ardhura të tjera		X
	Kosto të shpërndarjes		(X)
	Shpenzime administrative		(X)
	Shpenzime të tjera		(X)
		<hr/>	
	Fitimi		X
			<hr/>
93	<p><b>Njësitë ekonomike që klasifikojnë shpenzimet sipas funksionit duhet të japin informacion shpjegues shtesë lidhur me natyrën e shpenzimeve, përfshirë shpenzimet për amortizimin dhe përfitimet e punonjësve.</b></p>		
94	<p>Zgjedhja ndërmjet metodës së funksionit të shpenzimit dhe metodës së shpenzimeve sipas natyrës varet nga faktorët historikë e industrialë dhe nga natyra e njësisë ekonomike. Të dyja metodat sigurojnë një tregues lidhur me ato kosto që mund të variojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë me nivelin e shitjeve ose të prodhimit të njësisë ekonomike. Meqë secila prej metodave të paraqitjes vlen për tipe të ndryshme njësisish, ky Standard kërkon që drejtimi të zgjedhë paraqitjen më të rëndësishme dhe më të besueshme. Megjithatë për shkak se informacioni lidhur me natyrën e shpenzimeve është i dobishëm në parashikimin e flukseve të ardhshme monetare, kur përdoret klasifikimi sipas funksionit të shpenzimit duhet të jepet informacion shtesë shpjegues. Në paragrafi 93, “përfitimet e punonjësve” ka të njëjtin kuptim si në SNK 19 <i>Përfitimet e Punonjësve</i>.</p>		
95	<p><b>Një njësi ekonomike duhet të jap informacion shpjegues, në pasqyrën e të ardhurave ose në pasqyrën e ndryshimeve në kapital, ose në shënimet shpjeguese për shumën e dividendëve të njohur si shpërndarje për zotëruesit e kapitalit neto gjatë periudhës dhe vlerën përkatëse për aksion.</b></p>		

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital

- 96 Një njësi ekonomike duhet të paraqesë një pasqyrë të ndryshimeve në kapital e cila të tregojë:
- (a) fitimin ose humbjen e periudhës;
  - (b) çdo zë të të ardhurave dhe shpenzimeve të periudhës që, sipas kërkesave të Standardeve ose Interpretimeve të tjera, njihet drejtëpërsëdrejti në kapitalin neto, si dhe totalin e këtyre zërave;
  - (c) totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve të periudhës (llogaritur si shumë e pikave (a) dhe (b)) duke treguar veçmas shumat totale që i takojnë zotëruesve të kapitalit neto të shoqërisë mëmë dhe ato që i takojnë interesit të pakicës; dhe
  - (d) për secilin përbërës të kapitalit neto, efektet e ndryshimeve në politikat kontabël dhe korigjimet e gabimeve të njohura në përputhje me SNK 8.
- Një pasqyrë e ndryshimeve në kapital që përfshin vetëm këto zëra duhet të titullohet pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura.
- 97 Gjithashtu, një njësi ekonomike duhet të paraqesë në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose në shënimet shpjeguese:
- (a) shumën e transaksioneve me zotëruesit e kapitalit neto që veprojnë si zotërues të kapitalit neto, duke treguar veçmas shpërndarjet tek zotëruesit e kapitalit neto;
  - (b) tepricën e fitimit të pashpërndarë (d.m.th. fitimin ose humbjen e akumuluar) në fillim të periudhës dhe në datën e bilancit, si dhe ndryshimet gjatë periudhës; dhe
  - (c) një rakordim mes vlerës kontabël (neto) të çdo klase të kapitalit neto të kontribuar dhe çdo rezerve në fillim dhe në fund të periudhës duke paraqitur veçmas çdo ndryshim.
- 98 Ndryshimet në kapitalin neto të njësisë ekonomike mes dy datave të bilancit tregojnë rritjen ose pakësimin në aktivet neto të saj gjatë periudhës. Me përjashtim të ndryshimeve që vijnë nga transaksionet me zotëruesit e kapitalit neto që veprojnë si të tillë (si p.sh. kontributet e kapitalit neto, riblerjet instrumentave të kapitalit të vet dhe të dividendëve të njësisë ekonomike) dhe kostove të transaksionit të lidhura drejtëpërsëdrejti me transaksione të tilla, ndryshimi i përgjithshëm në kapitalin neto gjatë një periudhe përfaqëson shumën totale të të ardhurave dhe shpenzimeve, përfshirë fitimet dhe humbjet e gjeneruara nga aktivitetet e njësisë ekonomike gjatë periudhës (pavarësisht nëse këto zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve janë njohur si fitim/humbje ose drejtëpërsëdrejti si ndryshime në kapitalin neto).
- 99 Ky Standard kërkon që të gjitha zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë një periudhe të përfshihen në fitim ose humbje me përjashtim të rastit kur një tjetër Standard ose Interpretim e kërkon ndryshe. Standarde të tjera kërkojnë që disa fitime ose humbje (si p.sh. rritjet ose zbritjet nga rivlerësimi, diferencat specifike nga kurset e këmbimit, fitime ose humbjet nga rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje dhe shumat respektive të tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë) të njihen drejtëpërsëdrejti si ndryshime në kapitalin neto. Duke qenë se është e rëndësishme të merren në konsideratë të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve kur vlerësohen ndryshimet në pozicionin financiar të njësisë ekonomike ndërmjet dy balanceve të njëpësnjëshme, ky Standard kërkon paraqitjen e një pasqyre të ndryshimeve në kapital e cila thekson të ardhurat dhe shpenzimet totale të një njësie ekonomike duke përfshirë dhe ato që njihen drejtëpërsëdrejti në kapitalin neto.
- 100 SNK 8 kërkon rregullime prapavepruese për të reflektuar ndryshimet në politikat kontabël deri në masën që është e zbatueshme me përjashtim kur kushtet kalimtare të një Standardi ose Interpretimi tjetër kërkojnë ndryshe. SNK 8 kërkon gjithashtu që ripasqyrimet për korigjimin e gabimeve të bëhen për sa i përket së kaluarës deri në masën që është e zbatueshme. Rregullimet dhe riparaqitjet prapavepruese bëhen në tepricën e fitimit të pashpërndarë me përjashtim të rastit kur një Standard ose një Interpretim kërkon rregullim prapaveprues, të një përbërësi tjetër të kapitalit neto. Paragrafi 96(d) kërkon paraqitjen veçmas në pasqyrën e ndryshimeve në kapital të rregullimit total të secilit përbërës të kapitalit neto që rezulton nga ndryshimet në politikat kontabël dhe nga korigjimet e gabimeve. Këto rregullime paraqiten për çdo periudhë paraardhëse dhe për fillimin e periudhës.
- 101 Kërkesat në paragrafët 96 dhe 97 mund të plotësohen në mënyra të ndryshme. Një shembull është formati në kolona që rakordon tepricat fillestare dhe përfundimtare të secilit element të kapitalit neto.



Një alternativë është paraqitja në pasqyrën e ndryshimeve në kapital vetëm e zërave të ekspozuar në paragrafin 96. Sipas kësaj metode, zërat e përshkruar në paragrafin 97 paraqiten në shënimet shpjeguese.

## Pasqyra e fluksit monetar

- 102 Informacioni lidhur me fluksin monetar u siguron përdoruesve të pasqyrave financiare bazën për të vlerësuar mundësinë e njësisë ekonomike për të gjeneruar mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe nevojat e njësisë ekonomike për të përdorur këto flukse monetare. SNK 7 tregon kërkesat për paraqitjen e pasqyrës së fluksit monetar dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të caktuara.

## Shënimet shpjeguese

### Struktura

- 103 **Shënimet shpjeguese duhet të:**
- (a) **paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël specifike të përdorura në përputhje me paragrafët 108–115;**
  - (b) **japin informacion shpjegues të kërkuar nga SNRF-të i cili nuk është paraqitur në bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital ose pasqyrën e fluksit monetar; dhe**
  - (c) **japin informacion shtesë që nuk është paraqitur në bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital ose pasqyrën e fluksit monetar, por është i rëndësishëm për të kuptuar cilëndo prej tyre.**
- 104 **Shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe në pasqyrën e fluksit monetar duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.**
- 105 Zakonisht shënimet shpjeguese paraqiten në rendin që paraqitet në vijim, i cili ndihmon përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare dhe t'i krahasojnë ato me pasqyra financiare të njësive ekonomike të tjera:
- (a) një deklaratë për pajtueshmërinë me IFRS-të (shih paragrafin 14);
  - (b) një përmbledhje e politikave kryesore kontabël të zbatuara (shih paragrafin 108);
  - (c) informacion mbështetës për zërat e paraqitur në bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit monetar sipas radhës së paraqitjes së secilës pasqyrë dhe secilit zë; dhe
  - (d) informacione shpjeguese të tjera të cilat përfshijnë:
    - (i) Pasivet e kushtëzuara (shih SNK 37) dhe anagazhimet kontraktuale të panjohura; dhe
    - (ii) Informacionet shpjeguese jo-financiare p.sh. objektivat dhe politikat e njësive ekonomike për manaxhimin e riskut financiar (shih SNRF 7).}
- 106 Në disa rrethana mund të jetë e nevojshme ose e dëshirueshme të ndryshohet radha e zërave të caktuar brenda shënimeve shpjeguese. Për shembull informacioni për ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim ose humbje mund të kombinohet me informacionin lidhur me maturimin e instrumentave financiare, ndonëse paraqitja e parë lidhet me pasqyrën e të ardhurave dhe e dyta lidhet me bilancin kontabël. Megjithatë duhet të mbahet një strukturë sistematike për shënimet shpjeguese për sa kohë që është e zbatueshme.
- 107 Shënimet shpjeguese që japin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave specifike kontabël mund të paraqiten si një përbërës i veçantë i pasqyrave financiare.

## Dhënie informacionesh shpjeguese për politikat kontabël

- 108 Një njësi ekonomike duhet të japë në informacionin shpjegues përmbledhës për politikat kryesore kontabël:
- (a) bazën (bazat) e matjes së përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare; dhe
  - (b) politikat e tjera kontabël të përdorura që janë të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.
- 109 Është e rëndësishme për përdoruesit që të informohen lidhur me bazën ose bazat e matjes të përdorura në pasqyrat financiare (për shembull, kosto historike, kosto aktuale, vlera neto e realizueshme, vlera e drejtë ose shuma e rikuperueshme) sepse baza mbi të cilën janë përgatitur pasqyrat financiare ndikon në mënyrë të rëndësishme analizat e tyre. Nëse është përdorur më shumë se një bazë matjeje në pasqyrat financiare, për shembull kur klasa të caktuara të aktiveve rivlerësohen, është e mjaftueshme të jepet një informacion i kategorive të aktiveve dhe detyrimeve ndaj të cilëve është zbatuar secila bazë matje.
- 110 Kur vendos nëse një politikë kontabël e caktuar duhet të shpjegohet ose jo, drejtimi merr në konsideratë nëse informacionet shpjeguese do t'u vijnë në ndihmë përdoruesve për të kuptuar sesi transaksionet, ngjarjet dhe kushtet e tjera pasqyrohen në performancën financiare dhe pozicionin financiar të raportuar. Dhënia e informacioneve shpjeguese për politikat kontabël të caktuara është veçanërisht e dobishme për përdoruesit nëse këto politika zgjidhen nga alternativat e lejuara në Standardet dhe Interpretimet. Një shembull është dhënia e informacioneve shpjeguese nëse një sipërmarrës njerëz interesin e tij në një njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht duke përdorur metodën e konsolidimit proporcional ose metodën e kapitalit neto (shih SNK 31 *Pjesëmarrje në Sipërmarrjet e Përbashkëta*). Disa Standarde kërkojnë në mënyrë specifike dhënien e informacioneve shpjeguese për politika kontabël të caktuara, përfshirë zgjedhjet e bëra nga drejtimi mes politikave të ndryshme që lejojnë standardet. Për shembull, SNK 16 kërkon dhënie informacioni shpjegues për bazat e matjes të përdorura për klasat e tokës, ndërtesave, makinerive e pajisjeve. SNK 23 *Kostot e Huamarrjes* kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese nëse kostot e huamarrjes janë njohur menjëherë si një shpenzim apo janë kapitalizuar si pjesë e kostos së aktiveve të caktuara.
- 111 Çdo njësi ekonomike merr në konsideratë natyrën e operacioneve të saj dhe politikat që përdoruesit pasqyrave financiare të saj presin të shohin të jenë shpjeguar për atë lloj njësie ekonomike. Për shembull nga një njësi ekonomike subjekt i tatimit mbi të ardhurat, pritet që të japë informacion shpjegues lidhur me politikat e saj kontabël për tatimet mbi të ardhurat, përfshirë ato që zbatohen për aktivet dhe pasivet për tatime të shtyra. Nëse një njësi ekonomike ka operacione të rëndësishme jashtë vendit ose transaksione në monedhë të huaj, pritet që ajo të japë informacione shpjeguese lidhur me politikat kontabël për njohjen e fitimeve dhe humbjeve nga kurset e këmbimit. Nëse kanë ndodhur kombinime biznesi, duhet të jepet informacion shpjegues lidhur me politikat e matjes së emrit të mirë dhe interesit të pakicës.
- 112 Një politikë kontabël mund të jetë e rëndësishme për shkak të natyrës së operacioneve të njësisë ekonomike edhe pse shumat për periudhën aktuale dhe paraardhëse nuk janë materiale. Është gjithashtu e përshtatshme të jepet informacion shpjegues për çdo politikë kontabël të rëndësishme që nuk është kërkuar në mënyrë specifike nga SNRF-të por është zgjedhur dhe zbatohet në përputhje me SNK 8.
- 113 **Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, në përmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme ose në shënimet e tjera, lidhur me gjykimet, përveç atyre që përfshijnë çmuarje (shih paragrafin 116), që ka bërë drejtimi në procesin e zbatimit të politikave kontabël të njësisë ekonomike dhe që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare.**
- 114 Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të njësisë ekonomike, drejtimi bën gjykime të ndryshme, përveç atyre që përfshijnë çmuarje, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë të rëndësishme shumat e njohura në pasqyrat financiare. Për shembull, drejtimi bën gjykime në përcaktimin:
- (a) nëse aktivet financiare janë investime që mbahen deri në maturim;
  - (b) nëse në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme nga pronësia e aktiveve financiare dhe aktiveve me qira u janë transferuar njësisë ekonomike të tjera;
  - (c) nëse në thelb shitje të caktuara të mallrave janë marrëveshje financimi dhe për pasojë nuk sjellin të ardhura; dhe

- (d) nëse në thelb marrëdhënia mes njësisë ekonomike dhe një njësie ekonomike për qëllime të vecanta tregon se njësia ekonomike për qëllime të vecanta kontrollohet nga njësia ekonomike.
- 115 Disa nga dhëniet e informacioneve shpjeguese të bëra në përputhje me paragrafin 113 kërkohen nga Standarde të tjera. Për shembull, SNK 27 i kërkon një njësie ekonomike të japë informacion shpjegues lidhur me arsyet pse interesi i pronësisë së njësisë ekonomike nuk përbën kontroll, mbi një shoqëri që nuk është filial, edhe pse më shumë se gjysma e të drejtës së votave ose mundësisë për të votuar zotërohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë përmes filialeve. SNK 40 kërkon dhënie informacionesh shpjeguese lidhur me kriterin e përdorur nga njësia ekonomike për të dalluar aktivet afatgjata materiale të investuar nga pasuria e zotëruar nga pronari dhe nga aktivet e mbajtura për shitje në rrjedhën normale të biznesit, kur klasifikimi i pasurisë është i vështirë.

## Burimet kryesore për vlerësimin e pasigurisë

- 116 **Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në shënimet shpjeguese lidhur me supozimet kryesore për të ardhmen dhe burime të tjera kryesore për vlerësimin e pasigurisë në datën e bilancit, që kanë një rrezik të rëndësishëm për të shkaktuar një rregullim material në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar. Lidhur me këto aktive dhe detyrime, shënimet shpjeguese duhet të përfshijnë detaje për:**
- (a) natyrën e tyre; dhe
- (b) vlerën e tyre kontabël në datën e bilancit.
- 117 Përcaktimi i vlerës kontabël të disa aktiveve dhe pasiveve kërkon çmuarjen e efekteve të ngjarjeve të pasigurta të ardhshme mbi këto aktive dhe pasive në datën e bilancit. Për shembull, në mungesë të vrojtimit më të fundit në çmimet e tregut të përdorura për të matur aktivet dhe pasivet, janë të nevojshme çmuarje të orientuara nga e ardhmja për të matur shumën e rikuperueshme të klasave të tokës, ndërtesave, makinerive e pajisjeve, efekteve të amortizimit teknologjik (moral) të inventarëve, provizioneve objekt i përfundimit në të ardhmen i konflikteve në proces dhe pasiveve lidhur me përfitimet afatgjata të punonjësve si p.sh.detyrimet për pension. Këto çmuarje përfshijnë supozime rreth zërave të tillë si rreziku i rregullimit të fluksit të mjeteve monetare ose normave të përdorura të skontimit, ndryshimeve të ardhshme në pagat dhe ndryshimet e ardhshme në çmimet që ndikojnë kosto të tjera
- 118 Supozimet kryesore dhe burime të tjera kryesore të çmuarjes së pasigurisë të paraqitura në përputhje me paragrafin 116 lidhen me çmuarje që kërkojnë gjykime më të vështira, subjektive dhe të ndërlikuara nga ana e drejtimit. Me rritjen e numrit të variablave dhe supozimeve që ndikojnë zgjidhjet e mundshme të ardhshme të pasigurisë, këto gjykime bëhen më subjektive dhe të ndërlikuara dhe zakonisht rritet dhe mundësia për një rregullim material të mëvonshëm mbi vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve.
- 119 Dhëniet e informacionit në paragrafin 116 nuk kërkohen për aktive dhe pasive me një rrezik të madh që vlera kontabël e tyre mund të ndryshojë materialisht brenda vitit të ardhshëm financiar nëse në datën e bilancit, ato maten me vlerën e drejtë bazuar në vrojtimin më të fundit të çmimeve të tregut (vlera e drejtë e tyre mund të ndryshojë ndjeshëm brenda vitit financiar të ardhshëm por këto ndryshime nuk do të vijnë si rezultat i supozimeve ose burimeve të tjera të çmuarjes së pasigurisë në datën e bilancit).
- 120 Dhënia e informacionit shpjegues në paragrafin 116 paraqitet në një mënyrë që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë gjykimet e bëra nga drejtimi lidhur me të ardhmen dhe burimet të tjera kryesore të çmuarjes së pasigurisë. Natyra dhe gjerësia e informacionit që jepet ndryshon sipas natyrës së supozimit dhe rrethanave të tjera. Disa shembuj të llojeve të dhënies së informacioneve shpjeguese janë:
- (a) natyra e supozimit ose çmuarjes tjetër të pasigurisë;
- (b) ndjeshmëria e vlerës kontabël ndaj metodave, supozimeve dhe çmuarjeve duke theksuar llogaritjen e tyre, përfshirë dhe arsyet e kësaj ndjeshmërie;
- (c) zgjidhjen e pritur të një pasigurie dhe fushën e rezultateve me probabilitet të arsyeshëm brenda vitit të ardhshëm financiar, lidhur me vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve të ndikuara; dhe
- (d) një shpjegim i ndryshimeve të bëra ndaj supozimeve të mëparshme lidhur me këto aktive dhe pasive, nëse pasiguria mbetet e pazgjidhur.

- 121 Nuk është e nevojshme të jepet informacion shpjgues lidhur me buxhetimin ose parashikimet në përgatitjen e dhenies së informacioneve shpjguese të paragrafit 116.
- 122 Nëse është e pazbatueshme dhënia e informacionit shpjgues për madhësinë e efektit të mundshëm të një supozimi kryesor ose të burimit kryesor të çmuarjes së pasigurisë në datën e bilancit, njësia ekonomike jep informacion shpjgues se është me probabilitet të arsyeshëm, bazuar në njohuritë ekzistuese, se rezultatet brenda vitit të ardhshëm financiar që janë të ndryshëm nga supozimet mund të kërkojnë një rregullim material të vlerës kontabël të aktivitetit ose pasivitetit të ndikuar. Në të gjitha rastet njësia ekonomike jep informacion shpjgues për natyrën dhe vlerën kontabël të aktiveve ose **pasiveve** të caktuara (ose klasë aktiveve ose pasiveve) të ndikuara nga supozimi
- 123 Dhënia e informacionit shpjgues në paragrafin 113 për gjykime të veçanta të bëra nga drejtimi gjatë procesit të zbatimit të politikave kontabël të njësisë ekonomike nuk lidhet me paraqitjen e burimeve kryesore të çmuarjes së pasigurisë të paragrafit 116.
- 124 Dhënie e informacioneve shpjguese për disa prej supozimeve kryesore që ndryshe do të kërkohej në përputhje me paragrafin 116, kërkohet nga Standardet e tjera. Për shembull, SNK 37 kërkon dhënie informacionesh shpjguese, në rrethana të caktuara, të supozimeve kryesore lidhur me ngjarjet e ardhshme që ndikojnë klasën e provizioneve. SNRF 7 kërkon dhënie informacionesh shpjguese të supozimeve kryesore të zbatuara në çmuarjen e vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare që mbarten me vlerën e drejtë. SNK 16 kërkon dhënie informacionesh shpjguese të supozimeve kryesore të zbatuara në çmuarjen e vlerës së drejtë së zërave të rivlerësuar të tokës, ndërtesave, makinerive e pajisjeve.

## Kapitali

**124A Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjgues që u mundëson përdoruesive të pasqyrave financiare të saj të vlerësojnë objektivat, politikat dhe proceset për menaxhimin e kapitalit të njësisë ekonomike.**

- 124B Që të pajtohet me paragrafin 124, njësia ekonomike jep informacionet shpjguese vijuese:
- (a) informacion cilësor lidhur me objektivat, politikat dhe proceset e menaxhimit të kapitalit, të saj përfshirë (por pa u kufizuar vetëm në):
    - (i) një përshkrim se çfarë ajo menaxhon si kapital;
    - (ii) nëse njësia ekonomike është objekt i kërkesave të detyrueshme nga jashtë lidhur me kapitalin, natyrën e këtyre kërkesave dhe si këto kërkesa janë përfshirë në menaxhimin e kapitalit; dhe
    - (iii) sesi po i plotëson objektivat e saj për menaxhimin e kapitalit.
  - (b) të dhëna sasiore për atë çfarë njësia ekonomike menaxhon si kapital. Disa njësi ekonomike quajnë disa detyrime financiare (p.sh. disa forma të borxhit të nënrenditur) si pjesë e kapitalit. Njësi të tjera ekonomike e shohin kapitalin pa disa përbërës të kapitalit neto (p.sh. përbërësit që vijnë nga mbulimi i fluksit monetar).
  - (c) çdo ndryshim në pikat (a) dhe (b) kundrejt periudhës paraardhëse.
  - (d) nëse gjatë periudhës ka plotësuar ndonjë nga kërkesat e detyrueshme nga jashtë për kapitalin subjekt i të cilave ajo është.
  - (e) nëse njësia ekonomike nuk ka plotësuar ndonjë kërkesë të tillë të detyrueshme nga jashtë për kapitalin, pasojat e këtij mosplotësimi.

Këto dhënie informacioni shpjgues duhet të bazohen në informacionin e siguruar nga brenda për personelin kryesor drejtues të njësisë ekonomike.

124C Një njësi ekonomike mund të menaxhojë kapitalin në disa mënyra dhe mund të jetë objekt i një numri kërkesash të ndryshme për kapitalin. Për shembull, një konglomerat mund të përfshijë njësi ekonomike që ndërmarrin aktivitete siguroese dhe bankare dhe këto njësi ekonomike mund të veprojnë në vende me legjislacione të ndryshme. Nëse dhënia e informacioneve shpjguese totale lidhur me kërkesat për kapitalin dhe sesi është menaxhuar kapitali, nuk do të sigurojë informacion të dobishëm ose ç'orienton përdoruesit e pasqyrave financiare për të kuptuar burimet e kapitalit të një njësie ekonomike, njësia

ekonomike duhet të japë informacion shpjegues veçmas për çdo kërkesë për kapitalin të cilit duhet t'i nënshtrohet njëسيا ekonomike.

### **Informacione shpjeguese të tjera**

- 125 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në shënimet shpjeguese për:
- (a) shumën e dividendëve të propozuar ose të deklaruar përpara se të miratohen për t'u nxjerrë pasqyrat financiare por të panjohura si një shpërndarje ndaj zotëruesve të kapitalit neto gjatë periudhës si dhe vlerën përkatëse për aksion; dhe
  - (b) shumën e dividendëve preferencialë kumulativë të panjohur ende.
- 126 Një njësi ekonomike duhet të japë dhe informacionin shpjegues vijues, nëse ky informacion nuk është paraqitur diku tjetër në informacionin e publikuar me pasqyrat financiare:
- (a) adresën dhe formën ligjore të njësisë ekonomike, vendin e regjistrimit dhe adresën e zyrës së saj të regjistruar (ose vendin kryesor të biznesit nëse është i ndryshëm nga zyra e regjistruar);
  - (b) një përshkrim të natyrës së operacioneve të njësisë ekonomike dhe aktiviteteve kryesore të saj; dhe
  - (c) emrin e shoqërisë mëmë dhe emrin e shoqërisë mëmë të fundit për grupin.

### **Data e hyrjes në fuqi**

---

- 127 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kesaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 127A Një njësi ekonomike duhet të zbatojë ndryshimin në paragrafin 96 për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2006. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet e SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve—Fitime dhe Humbje neto Aktuariale, Planet e grupit dhe Dhënie Informacionesh Shpjeguese* për një periudhë më të hershme, ky ndryshim duhet të zbatohet për atë periudhë të hershme.
- 127B Një njësi ekonomike duhet të zbatojë kërkesat e paragrafëve 124A–124C për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2007. Inkurajohet zbatimi i më hershëm.

### **Tërheqja e SNK 1 (të rishikuar 1997)**

---

- 128 Ky Standard zëvendëson SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* të rishikuar në 1997.